



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri

PROFILI I PËRJASHTIMIT SOCIAL TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE

Tetor 2015



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



United Nations
ALBANIA



Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri

PROFILI I PËRJASHTIMIT SOCIAL TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE

Tetor 2015

Ky raport është realizuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri, në kuadrin e projektit "Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri" (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) të Kombeve të Bashkuara (KB).

Tiranë, Tetor 2015

Përgatitur nga: Marsela Dauti, PhD¹

*Imazhi i kopertinës:
Pikturë nga Rudina Proda*

PËRMBLEDHJE

Në qendër të vëmendjes së këtij studimi është profili i përjashtimit shoqëror të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Studimi, që bazohet në 34 intervista të thelluara të zhvilluara me anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, aktivistë të komunitetit, ofrues të shërbimeve, dhe zyrtarë qeveritarë në Tiranë, hedh dritë mbi barrierat ndaj përfshirjes sociale. Studimi tregon se romët dhe egjiptianët janë zënë në kurthe të shumëfishta – kurthi i varfërisë, ai arsimor, shëndetësor, i punësimit dhe ai institucional – që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe përjetësojnë varfërinë dhe përjashtimin social ndër breza. Rregullat dhe praktikat institucionale i penalizojnë romët dhe egjiptianët për varfërinë e tyre. Shpesh ofruesit e shërbimeve dhe profesionistët nuk kanë një kuptim të thelluar të varfërisë dhe diskriminimit brez pas brezi dhe përdorin nocione të gabuara për të shpjeguar sjelljet kundër-produktive. Ndërveprimet shoqërore thellojnë tëhuajzimin dhe mungesën e besimit të romëve dhe egjiptianëve dhe përjetësojnë përjashtimin social. Gjetjet e studimit nënvizojnë rëndësinë që ka rrëzimi i koncepteve të gabuara për romët dhe egjiptianët. Nxitja e përfshirjes sociale të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri kërkon një kapërcim madhor konceptual: kalimin nga një qasje që fajëson viktimën, në një qasje që merr parasysh pasojat psikologjike dhe në sjellje që shkakton varfëria dhe diskriminimi brez pas brezi.

Përmbajtja e Lëndës

1. Hyrje	5
2. Metodologjia	8
3. Gjetjet	9
Kurthi i varfërisë	9
Kurthi shëndetësor	14
Kurthi arsimor	18
Kurthi i punësimit	21
Kurthi institucional	24
4. Përfundime dhe rekomandime	29
5. Referenca	31

HYRJE

Familja e Zanës, një grua e re rome që e takova në një nga lagjet më të varfra të Tiranës, përbëhej nga pesë anëtarë. Ajo më tregoi për rutinën e saj të përditshme:

Zgjohem në orën 6 të mëngjesit, ziej vezë për fëmijët e vegjël, i ushqej fëmijët dhe pastaj unë dhe burri dalim nga baraka. Ne grumbullojmë mbeturina. Ndonjëherë fitoj 5 mijë lekë (të vjetra)^a, ndonjëherë 10 mijë (të vjetra), ndonjëherë nuk fitoj asgjë. Të gjitha sa fitoj, i harxhoj. U gatuj fëmijëve diçka për të ngrënë. Shpresa e vetme që kam është që fëmijët e mi të mos shkojnë të flenë pa ngrënë.

Secili nga anëtarët e familjes së Zanës kishte një ose më shumë nga problemet e mëposhtme shëndetësore – astmë, diabet, migrenë, dhe epilepsi. Vetë Zana shfaqte simptomat e depresionit: pesimizëm, pagjumësi dhe trishtim. Ajo jetonte në një lagje mbushur me konflikte, dhunë, abuzim droge, dhe krime. Zana paguante për qira 50 mijë lekë në muaj. Ajo rronte me frikën e dëbimit, si dhe me frikën se mos i mbyteshin fëmijët në lumin aty pranë. Ajo i donte fëmijët e saj, ishte krenare për ta dhe ndihej fajtores që nuk i çonte në shkollë. Zana është një nga ato shumë gra të guximshme që kam takuar, që janë të mbërthyera në kurthe të shumëfishta.

Mënyra më e lehtë dhe e gabuar për të shpjeguar gjendjen e Zanës është të mbështetemi në karakteristikat e saj kulturore. Po të ndiqej një arsyetim i tillë, do të argumentohet se në kulturën e saj ka diçka të veçantë që e bën atë të jetë e varfër dhe e përjashtuar. Për shembull, ajo nuk punon sa duhet, apo i pëlqen vetë të jetojë në një barakë pothuaj të rrënuar. Për fat të keq, në këto lloj konceptesh të gabuara bazohen debatet publike dhe politike dhe, siç do të tregojmë, ato madje bëhen edhe pjesë e politikë-bërjes.

Për personat e varfër ekzistojnë shumë koncepte të gabuara. Shpesh, karakteristikat e tyre kulturore konsiderohen si të një niveli më të ulët dhe propozohen politika për t'i "ndrequr" ato. Pjesërisht, kjo ndikohet edhe nga mënyra se si perceptohet kultura. Zakonisht, kultura shihet sipas këndvështrimit normativ, si një grup bindjesh, zakonesh dhe vlerash të përbashkëta. Shumë studiues argumentojnë se kultura duhet të shihet sipas këndvështrimit njohës, dhe jo atij normativ. Duke iu referuar Small (2010), "kultura mendohet pothuaj si një palë gjyzykë që i mbajmë, të cilat i japin formë mënyrës se si e shohim botën ... ky është një koncept 'i kornizuar' i kulturës; ai mbështetet në të kuptuarit njohës të kulturës dhe jo në idenë se ne jemi të ndryshëm sepse kemi vlera të ndryshme" (para. 6). Këndvështrimi njohës është kundër perceptimit se njerëz nga kultura të ndryshme kanë disa dallime të brendshme që i ndajnë nga njëri-tjetri.

Për të shpjeguar profilin e përjashtimit social të romëve dhe egjiptianëve, jemi mbështetur tek literatura për varfërinë. Studimet kërkimore tregojnë se varfëria shkakton stres dhe ndjenja negative. Stresi është i lidhur me depresionin, i cili nga ana e tij minon produktivitetin e punës.

^a Pjesëmarrësit në studim janë shprehur me lekë të vjetra.

Stresi dhe ndjenjat negative gjithashtu ulin gatishmërinë e njerëzve për të bërë investime afatgjata, si investimi në arsim (Houshofer, 2014). Përveç këtyre, në praninë e ndjenjave negative, njerëzit parapëlqejnë shpërblimet afatshkurtra mbi ato afatgjata. Lerner dhe bashkëautorët (2013) tregojnë se trishtimi i bën njerëzit të kërkojnë plotësimin e nevojave dhe kënaqësive të çastit, çka mund të përkeqësojë gjendjen e tyre financiare në periudhën afatgjatë.

Mullainathan dhe Shafir (2013) argumentojnë se jeta në varfëri shkakton mentalitetin e mungesës. Varfëria "i shtyn njerëzit ta përqendrojnë vëmendjen në çështjet më të dukshme dhe më të ngutshme, në dëm të çështjeve të tjera që mund të jenë po aq të rëndësishme, por jo aq të ngutshme" (Houshofer, 2014, para. 16). Për shembull, nëse prindërit nuk arrijnë të fitojnë të ardhura të mjaftueshme, perceptimi i tyre është se arsimit nuk është i dobishëm. Mungesat imponojnë një mënyrë të menduarit "ose... ose", që kërkon bërjen e kompromiseve. Një pyetje e përhershme në kushtet e mungesës është: Çfarë duhet të lë pa marrë, që të kem mundësi të blej gjërat më të domosdoshme? Për shembull, a t'i përdor paratë e ndihmës ekonomike për të paguar barnat, apo për të paguar qiranë? Korrupsioni dhe zbatimi i dobët i ligjit e ushqejnë më tej këtë mentalitet të mungesës dhe pamjaftueshmërisë.

Sipas modelit të burimeve të kufizuara të vetëkontrollit (Vohs, 2013), në qoftë se njerëzit vazhdimisht i shtypin shtysat e brendshme (për shembull, për ushqim, të holla, gjumë) dhe marrin vendime "ose... ose", "gjasat janë më të mëdha që ata të hanë dhe të shpenzojnë në mënyrë të tepruar, si dhe të shfaqin sjellje të tjera problematike" (f. 970). Vohs (2013) konstatoi se "vendimet që kërkojnë bërjen e kompromiseve të shumta, që janë mjaft të zakonshme në kushtet e varfërisë, i bëjnë vendimet e mëtejshme të prirjen drejt parapëlqimit të zgjedhjeve të çastit, intuitive dhe shpesh të vajtueshme" (p. 970). Përveç kësaj, kufizimet e vazhdueshme kanë një ndikim kumulativ. Me fjalë të tjera, "njerëzit, sa më shumë t'i bënin qëndresë dëshirave të padëshiruara, aq më të dobët e kishin vetëkontrollin" (f. 970). Këto përfundime hedhin dritë mbi arsyet që qëndrojnë në themel të sjelljeve kundër-produktive. Kur burimet janë të kufizuara, vetëkontrolli bëhet i vështirë.

Provat tregojnë se ekziston një marrëdhënie e ndërsjellë ndërmjet varfërisë dhe sjelljeve kundër-produktive (Mani dhe bashkëautorët, 2013). Për shembull, të varfrit e kanë të vështirë të jenë të përpiktë në takime, ata shpenzojnë më tepër se duhet, ose nuk i menaxhojnë mirë të ardhurat e tyre. Sjelljet kundër-produktive e thellojnë më tej varfërinë. Për të shpjeguar sjelljet kundër-produktive, Mani dhe bashkëautorët (2013) i referohen proceseve mendore që kërkon varfëria. Nëse personat e varfër janë thellësisht të preokupuar me shqetësime të buxhetit, ata i kushtojnë më pak burime njohëse gjërave që i konsiderojnë më pak të rëndësishme. Varfëria "pushton vëmendjen, shkakton mendime që nuk të lenë të qetë, dhe pakëson burimet njohëse" (Mani dhe bashkëautorët, 2013, f. 978).

Ky i kuptuar i thelluar i pasojave psikologjike dhe atyre në sjellje të shkaktuara nga varfëria e përcjellë brez pas brezi është i rëndësishëm sepse sugjeron që përkrahja e Zanës nuk duhet të jetë e lidhur me fajësimin e saj, por me të kuptuarit e shkaqeve që qëndrojnë në themel të varfërisë dhe përjashtimit të saj, si dhe me krijimin e mekanizmave të duhur për ta nxjerrë atë nga varfëria. Kjo qasje jo e thjeshtëzuar do të na japë mundësinë ta ndihmojmë Zanën dhe familjen e saj të përmirësojnë jetën e tyre.

Ky studim fokusohet në profilin e përjashtimit social² të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Ai trajton pyetjet në vijim: Si e përjetojnë romët dhe egjiptianët përjashtimin social? Si ndryshojnë përvojat e përjashtimit social në bazë të karakteristikave individuale, si gjinia dhe mosha? Cilat janë këndvështrimet e ofruesve të shërbimeve dhe aktivistëve të komunitetit për përjashtimin social? Çfarë lloj strategjish mund të përdoren për ta trajtuar përjashtimin social dhe për të shtuar mundësitë e romëve dhe egjiptianëve për të pasur qasje në shërbime? Në këtë studim, përjashtimin social e shqyrtojmë në lidhje me shërbimet e mëposhtme: punësimi dhe formimi profesional, arsimit, strehimi social, drejtësia, dhe mbrojtja sociale.

Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve u zhvilluan intervista të thelluara me anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, aktivistë të komunitetit, ofrues të shërbimeve, dhe zyrtarë qeveritarë në Tiranë. Studimi tregon se romët dhe egjiptianët e varfër janë mbërthyer në kurthe të shumëfishta që i mbajnë të zhytur në një varfëri dhe përjashtim social të vazhdueshëm. Rregullat dhe praktikat institucionale i penalizojnë romët dhe egjiptianët për varfërinë e tyre. Shpesh, ofruesit e shërbimeve nuk kanë një të kuptuar të thelluar për varfërinë dhe diskriminimin e përcjellë ndër breza, dhe përdorin konceptet e gabuara ekzistuese për të shpjeguar sjelljet kundër-produktive. Ndërveprimet me ofruesit e shërbimeve e thellojnë tëhuajzimin dhe mungesën e besimit të romëve dhe egjiptianëve dhe i zgjasin jetën përjashtimit social.

Pjesa vijuese e raportit përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e dytë përshkruan metodologjinë; pjesa e tretë parashtron gjetjet; dhe pjesa e katërt jep përfundimet dhe rekomandimet.

² Në këtë studim, përjashtimi social përkufizohet si "mohimi sistematik i të drejtave për burime dhe shërbime, dhe mohimi i të drejtës për të marrë pjesë në kushte të barabarta në marrëdhëniet sociale në fushat ekonomike, shoqërore, kulturore, dhe politike" (GSDRC, pa datë, para. 1).

METODOLOGJIA

Ky studim mbështetet në intervista të thelluara të zhvilluara me anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, ofrues të shërbimeve, zyrtarë qeveritarë, dhe aktivistë në komunitet në Tiranë. Gjithsej u zhvilluan 34 intervista të thelluara, nga të cilat njëra ishte intervistë në grup me aktivistë rom dhe egjiptian (numri i pjesëmarrësve dhe pjesëmarrësve në studim: 45; 60 për qind ishin gra; gama e moshave: 18 – 63 vjeç). Intervistat zgjatën nga 30 minuta deri në 1 orë e 30 minuta.

Intervistat me anëtarët e komunitetit u fokusuan tek përvojat e tyre të përjashtimit social; ndërveprimet me zyrtarë shtetërorë, ofruesit e shërbimeve dhe profesionistët; dhe mënyrat e trajtimit të përjashtimit social. Pyetjet me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile u përqendruan tek puna e tyre; llojet e ndërhyrjeve që zbatohen në komunitetet shqiptare; mënyrat e trajtimit të përjashtimit social; ndërhyrjet që kanë qenë të suksesshme (ose jo); dhe sugjerime për trajtimin e përjashtimit social. Pyetjet me ofruesit e shërbimeve dhe zyrtarët u përqendruan tek puna e tyre me komunitetet rome dhe egjiptiane; mënyrat e trajtimit të përjashtimit social; dhe sugjerime për trajtimin e përjashtimit social. Pyetjet për aktivistët e komunitetit u përqendruan tek përpjekjet e tyre për të nxitur ndryshime në politika dhe promovimin e të drejtave të romëve dhe egjiptianëve. Intervistat u zhvilluan me përfaqësues të organizatave të mëposhtme: Fëmijët e Botës dhe Shqipërisë, Arsis, Qendra Tranzitore e Emergjencave, Avokatit i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe Shërbimi Ligjor Falas – Tiranë.

Në studim u përdorën dy lloj strategjish të kampionimit të qëllimshëm: kampionimi me bazë variacionin dhe kampionimi me bazë rastet e krahasueshme. Qëllimi i kampionimit me bazë variacionin u përdor për të ngërthyer variacionet brenda popullatës, sidomos për të ngërthyer përvojat e grave, burrave, të rinjve dhe të rejave mbi 18 vjeç dhe personave më të moshuar. Kampionimi me bazë variacionin u përdor gjithashtu për të identifikuar ofruesit e shërbimeve në fushat e punësimit dhe të formimit profesional, arsimit, shëndetësisë, strehimit social dhe integritimit urban, drejtësisë dhe mbrojtjes sociale.

Në zgjedhjen e pjesëmarrësve nga komuniteti ndihmuan anëtarët e personelit të organizatës Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë. Organizata ka përvojë të gjatë në disa prej lagjeve më të varfra të Tiranës. Disa intervista u zhvilluan në komunitet, ndërsa të tjera në mjediset e organizatës. Për të bërë intervistat, studiuesja, së bashku me një anëtare të stafit, vizituan lagjet ku vepron kjo organizatë, si Bregu i Lumit. U kontaktuan anëtarë dhe anëtare të komunitetit rom dhe egjiptian dhe u pyetën nëse ishin të gatshëm të merrnin pjesë në studim. Në informacionin hyrës, atyre iu shpjegua se qëllimi i studimit nuk ishte vlerësimi i punës së organizatës. Aktivistët dhe zyrtarët shtetërorë u kontaktuan me telefon ose me anë të postës elektronike, dhe iu kërkua të merrnin pjesë në studim.

Intervistat u regjistruan në audio dhe u zbardhën verbatim. Për analizimin e të dhënave u përdor analiza tematike (Bernard, 2011). Gjatë procesit të analizimit të të dhënave u përdorën katër teknika për identifikimin e temave: përsëritja, ngjashmëritë dhe dallimet, metaforat dhe analogjitë, dhe tipologjitë indigjene (Ryan dhe Bernard, 2003).

GJETJET

Nga analiza e bërë dolën tematikat e mëposhtme: kurthi i varfërisë, kurthi arsimor, kurthi i punësimit dhe kurthi institucional.

Kurthi i varfërisë

Familjet rome dhe egjiptiane janë zënë në kurthin e një varfërie të thellë. Ata ndajnë hapësira të vogla banimi me anëtarë të shumtë të familjes. Ndihma ekonomike shpesh përdoret për të paguar borxhet. Të qenit në borxh sjell dhe pasojën jo të qëllimshme të tensionimit të marrëdhënieve brenda familjes dhe lagjes. Për të mbijetuar, romët dhe egjiptianët përdorin shumë strategji, si mobilizimi i të gjithë anëtarëve të familjes për fitimin e jetesës, dhe bërja e kompromiseve ndërmjet zgjedhjeve alternative. Megjithatë, këto strategji nuk i lejojnë ata të shpëtojnë nga kurthi i varfërisë. Dalja nga kurthi i varfërisë kërkon që ata të kursejnë, të kenë qasje në një punë të qëndrueshme dhe strehim të sigurtë. Kurthi i varfërisë ndërvepron me kurthin e ushqyerjes, kurthin shëndetësor, dhe kurthin e punësimit, duke sjellë kështu vazhdimin e mëtejshëm të përjashtimit social. Për shembull, romët dhe egjiptianët e varfër nuk mund të përballojnë financiarisht të hanë në mënyrë të shëndetshme dhe të marrin përbërësit kyç të një ushqyerje të shëndetshme. Si rezultat, shëndeti i tyre përkeqësohet. Kjo sjell uljen e produktivitetit të punës së tyre, si dhe thellimin e mëtejshëm të varfërisë.

Zana³ dhe familja e saj, e përbërë nga pesë anëtarë, banonin në një dhomë të vogël. Rita dhe familja e burrit të saj banonin në dy dhoma. Moza jetonte me kunatën dhe kunatin. Ajo tha: “Jemi tri familje nën një çati.” Drita jetonte në një dhomë të vogël me djemtë, nipërit dhe mbesën e vet. Djali i madh vuante nga kanceri dhe më i vogli kishte probleme të shëndetit mendor. Ajo nuk mund ta përballonte faturën e energjisë elektrike. Ja se e përshkroi Drita gjendjen e saj:

Sa mbaruan zgjedhjet, na i prenë dritat. Ne s’e paguam dot faturën e dritave. Rroftë qeveria!

Sa ke për të paguar? e pyeta.

600 000 lekë. Ku t’i gjej 600,000 lekë? Ata nuk duan t’ia dinë. Po afrohet dimri. Çfarë do të bëhet me neve? Shpresoj të gjej një sobë. Përndryshe do ngrijmë nga të flohtët ... S’e kam paguar faturën e dritave se nuk kisha lekë. S’kam frigorifer. S’kam makinë larëse. Të vetmet orendi që kam në shtëpi janë dy divane.

Qenia pjesë e një familjeje të madhe ka të mirat dhe të këqijat e veta. Familja e madhe shërben si rrjet shpëtimi. Anëtarët e familjes mbështeten tek njëri-tjetri, sidomos në raste emergjencash. Resmijes iu desh ta linte punën për shkak të problemeve shëndetësore. I shoqi

³ Emrat e pjesëmarrësve në studim janë ndryshuar për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

nuk mund ta ndihmonte, se ishte vetë i papunë. Por, iu gjend vjehrra, e cila e ndihmoi të merrte trajtim mjekësor. "Jemi me shumë fat që jetojmë me të. Nuk e di si do t'ia bënim pa të," tha ajo. Pastaj shtoi: "Ajo shkon në fshatrat këtu afër dhe shet rroba të përdorura." Moza gjithashtu përmendi se ndarja e një hapësire të vogël me familjen e burrit nuk ishte e lehtë: "Ne grindemi gjithë kohën, edhe për gjërat më të vogla e të parëndësishme. Fëmijët e mi nuk bëjnë dot detyrat se i ndërpresin tërë kohën." Sano kujdesej për nipat dhe mbesat e saj. E pyeta nëse shkonin mirë me shkollë. "Si mund të shkojnë mirë me shkollën?" u përgjigj. Tre nipat dhe një mbesë e saj jetonin në të njëjtën dhomë me gjyshen dhe me dy anëtarë të tjerë të familjes që vuanin nga probleme të shëndetit mendor.

Prindërit e kishin shqetësim të madh kur fëmijët shkonin për të fjetur pa ngrënë. Një nënë e re tha:

Fëmijët duan të hanë shumë më tepër; ata duan të hanë fruta, ata i duan të gjitha, po ne s'ua blejmë dot. Në qoftë se punoj – sot s'kam punuar se isha e sëmurë – të shohim se çdo bëjmë. Do të shkojmë në një dyqan e të marrim ndonjë gjë. Po t'i kemi borxh më shumë se 50 mijë lekë, nuk na japin gjë.

Një nga strategjitë për mbijetesë të romëve dhe egjiptianëve është mobilizimi i gjithë anëtarëve të familjes. Ata lypin, mbledhin shishe plastike, ose sende të tjera. Lida na tregoi përvojën e saj:

Unë zgjohem në orën 6 të mëngjesit. I zgjoj edhe fëmijët dhe shkojmë të lypim. Fitoj 5 ose 6 mijë lekë. Pastaj kthehem në shtëpi dhe bëj për të ngrënë. Asnjëherë nuk na del; kam tre fëmijë. Pastroj, gatuj, pres burrin dhe kur kthehet ai në shtëpi, përgatis diçka për të ngrënë.

Një nga supozimet që bëhen rëndom është se romët dhe egjiptianët janë të kënaqur me jetën e tyre. Ata janë "ku rafsha, mos u vrafsha" dhe nuk e vrasin mendjen shumë për të ardhmen e tyre. Nuk kujdesen për fëmijët e tyre. Duan vetëm të bëjnë qejf e të pijnë raki. "Ku ka më shumë varfëri, bëhet më shumë qejf," tha një nga punonjësit e komunitetit. Intervistat treguan të kundërtën. Romët dhe egjiptianët ishin të mbytur nga vuajtjet dhe vështirësitë. "Është e vështirë të bësh jetën që bëjmë ne. Ne mbledhim mbeturina, dhe po bëhet gjithnjë e më e vështirë," tha një nga të intervistuarat. Pastaj shtoi: "Na duhet të lypim, dhe nuk është e lehtë. Ne lypim sepse nuk kemi mënyrë tjetër për të mbijetuar. Kemi fëmijë. S'kemi një strehë. Është e vështirë dhe po bëhet gjithnjë edhe më e vështirë."

Një strategji tjetër për mbijetesë është përdorimi i ndihmës ekonomike për të shlyer borxhet. Ja si e përshkroi një prej personave të intervistuar ndihmën ekonomike: "Ne nuk zgjidhim asnjë problem me ndihmën ekonomike. Thjesht paguajmë borxhet. Kur hyjmë në dyqanin [e lagjes] dhe blejmë diçka, i premtojmë se do ta paguajmë më vonë. Në fund të muajit, ia çojmë paratë e ndihmës ekonomike dyqanit." Një e intervistuar tjetër na tha diçka të ngjashme: "Unë shkoj nga një dyqan në tjetrin dhe i premtoj secilit se do t'ia jap paratë. Gënjej sepse dua të ha, megjithëse më vjen turp kur dal nëpër lagje."

Të qenit në borxh ka pasoja të shumëfishta: ai shkakton marrëdhënie të tensionuara në lagje si dhe brenda familjeve. Një nga të intervistuarat tha se "ajo [pronarja e dyqanit] më bërtet, më ulëret, më ofendon. Ajo më kërcënon. Djalin e ka polic." Mbledhësi i borxheve mund të dojë të marrë hak ose të vendosë të ndërpresë burimin.

Jeta në varfëri do të thotë që gjithmonë duhen bërë zgjedhje "ose... ose". Romët dhe egjiptianët janë të përfshirë vazhdimisht në një luftë ndërmjet çka u duhet të blejnë, dhe se çka kanë mundësi të blejnë. Atyre u duhet të bëjnë zgjedhje të vështira. Ata blejnë sapun në vend të shamos. Prindërit rrinë pa ngrënë që t'ua lënë ushqimin fëmijëve. "Çfarë hëngre për mëngjes?"; e pyeta një nga nënat. "Unë dhe burri nuk kemi ngrënë gjë. Bëra diçka për fëmijët dhe pastaj dolëm. Do hamë drekë e darkë kur të kthehem nga puna."

Një nga mënyrat përmes të cilave familjet rome dhe egjiptiane mund të dalin nga kurthi i varfërisë është përmes kursimit të parave. Po pse nuk po kursejnë para? Pamundësia për të kursyer ndikohet nga shumë faktorë. Së pari, siç tregojnë përvojat e tyre, ata kanë shumë pak të ardhura:

Unë jam kryefamiljar. Kam dy vajza e dy djem. Ne jetojmë në vështirësi, siç i thonë, punojmë në tregun e zi. Mbledhim kanoçe dhe gjëra të tjera. Është shumë e vështirë të jetosh në këtë vend. Vuajmë shumë, siç e shikon. Por bëjmë përpjekje; sakrifikojmë. Mendohe mi për një kothere bukë, jo për gjëra të mëdha. Siç e shihni, nuk kemi mall.

Nuk mund të mbështetemi në kursimet tona, se nuk kemi kursime. Prandaj duam të kemi diçka për ditë. Të paktën të kemi aq [para] sa shpenzojmë.

"A mund të kurseni ndonjë gjë nga ato që sjellin djemtë në shtëpi në fund të ditës?", e pyeta Lidën. Ajo më tha:

[Mund të marr] një kothere bukë. Ja ta hap frigoriferin e ta shohësh. Ja kaq kam brenda në frigorifer. Ata [djemtë] do të sjellin bukë, por asgjë tjetër. Ne punojmë sa për mbushur barkun. Nuk mund të kursejmë për të ardhmen.

Personat e intervistuar u shprehën se paratë që fitojnë i përdorin kryesisht për blerjen e ushqimeve dhe për të paguar qiranë. Anila tha:

Ne marrim 5 ose 10 mijë lekë. Mbajmë një mijë ose 500 për qiranë dhe pjesën tjetër e harxhojmë për ushqime. Duhet të blejmë dhe detergent. Jemi shtatë vetë në shtëpi... Kur marrim ndihmën ekonomike, e përdorim për të paguar borxhet.

Së dyti, ata kanë shumë kërkesa, për shkak të numrit të madh të anëtarëve të familjes. Për shembull, një e ardhur prej 300 mijë lekë është shumë e vogël për një familje me 9 persona.

Një mënyrë tjetër përmes së cilët të varfrit mund të shpëtojnë nga kurthi i varfërisë është duke pasur një punë të qëndrueshme. Ne do të tregojmë se punët e qëndrueshme, edhe kur ekzistojnë, shpesh dalin se janë të paqëndrueshme. Pagat nuk jepen në kohë, ose janë shumë të ulëta. Në pjesët vijuese do të diskutojmë se si të papriturat shëndetësore dhe sjelljet kundër-produktive minojnë edhe përpjekjet për të kursyer.

Mungesa e një strehimi të sigurtë dhe të përballueshëm e përforcon hendekun e varfërisë. "Shtëpia është e para," tha një nga të intervistuarit. Pastaj shtoi: "Problemi kryesor është se nuk kemi një shtëpi apo një truall tonin tonën ku të ndërtoj një barakë, që e di se është e imja dhe nuk paguaj qira. Ato që mbledh i përdor për të ushqyer fëmijët."

Një i intervistuar tjetër shpjegoi se stina e dimrit është më e vështira dhe njëkohësisht më e rrezikshmja:

Ne e kemi jetën në rrezik. Çdo dimër vuajmë shumë. Lumi ngrihet aq lart sa që mezi dalim nga baraka. Kemi frikë të dalim. Qëndrojmë brenda; nuk mund t'i lëmë fëmijët vetëm. Fëmija mund të jetë duke luajtur dhe papritur zhduket. Pesë fëmijë janë mbytur në këtë lagje.

Vetëm disa familje kanë bërë investime në shtëpitë e tyre. Zakonisht ato kanë një burim të qëndrueshëm të ardhurash. Edhe në këto raste, ato kishin shqetësimin se mund t'i dëbonin.

Shumë gjëra që bëjnë prindërit romë dhe egjiptianë kalojnë pa u vënë re. Ata rrinë pa ushqim për fëmijët e tyre, i mbrojnë fëmijët nga mbytja, dhe shkojnë në shtrat në darkë me barkun bosh. Shumë prindër ishin krenarë për fëmijët e tyre. "Falë Zotit kam fëmijë të mrekullueshëm. Nuk e di çfarë do të ndodhë më vonë, por tani për tani mund të them se fëmijët i kam të mrekullueshëm." Artani ngrihet herët në mëngjes për të mbledhur mbeturina. Ai e merr edhe djalin me vete. Ai e ndan punën në mënyrë të tillë që djali të bëjë pjesën më të lehtë. Për shembull, djali kërkon vetëm materiale të ricikluara, ose bën roje në kazanët e plehrave. "Prandaj e mora djalin me vete, sepse vrau këmbën duke djegur kablllo. Ai digjte kabllot dhe i sillte lekët në shtëpi. E marr me vete, sepse përndryshe mund të vritet," tha Artani. Dhe pastaj shtoi: "Jeta është luftë."

Kurthi i varfërisë është i lidhur ngushtë me kurthin e të ushqyerit. Personat e intervistuar nuk i përballonin dot ushqimet e pasura me lëndë ushqyese, si frutat, perimet, mishin apo peshkun e freskët. "Nuk blejmë dot fruta," tha një nënë e re romë. Pastaj shtoi: "Ka një vit që s'kemi ngrënë mish." Një tjetër nënë e re tha: "Ndihmën ekonomike herë e marrim e herë s'e marrim... Ne duam të hamë shumë më tepër, po nuk i blejmë dot." Pastaj ajo përmendi që shkon për të fjetur pa ngrënë. Po kështu, një nënë tjetër tha: "Fëmijët duan të hanë shumë më tepër; ata duan të hanë fruta, ata i duan të gjitha, po ne s'ua blejmë dot. Në qoftë se punoj – sot s'kam punuar se isha e sëmurë – të shohim se çdo bëjmë. Do të shkojmë në një dyqan e të marrim ndonjë gjë. Po t'i kemi borxh më shumë se 50 mijë lekë, ata [pronarët e dyqaneve] nuk na japin gjë."

Ofruesit e shërbimeve dhe punonjësit e komunitetit nuk kishin kuptim të thelluar të varfërisë brez pas brezi dhe ndikimit të saj tek individët dhe familjet. Ata ua vinin fajin romëve dhe egjiptianëve për veprimet e tyre. Përveç kësaj, ata na treguan disa veprime që ata i quanin të pakuptueshme, për shembull, shpenzimet e tepruara që bënin romët dhe egjiptianët, pirja e tepruar e alkoolit, ose fakti që nuk i çonin fëmijët e sëmurë në spital. Më poshtë janë renditur disa shembuj:

Të ardhurat i kanë goxha të larta; ndoshta 2 ose 3 herë më të larta se tonat. Po nëse fitojnë 20 apo 30 mijë lekë, i harxhojnë që sot dhe s'u mbetet gjë për nesër.

Fëmija ka thyer krahun. Pse nuk e çojnë në spital? ... Pse presin nga ne t'ua çojmë fëmijën në spital?

Ne u gjejmë punë dhe ata thonë do shkojnë nesër, do shkojmë pasnesër, po nuk shkojnë kurrë.

Ata nuk e kanë shpirtin e punës. Unë i njoh shumë mirë. Ata nuk e kanë, dhe unë i kam parë në komunitet. Unë i them, ju çoj unë tek vendi; ju prezantoj unë [me punëdhënësin e mundshëm]. Nuk vinë; e kanë për më mbarë t'i marrin anëtarët e familjes me vete për të lypur se sa të shkojnë në punë.

Shkuan në spital vetëm për një kontroll. E kishin lënë fëmijën pas dore. Thanë se ishte mirë. Nuk ka temperaturë. Nuk ka faj doktori për këtë. Kjo është.

Nga ana tjetër, anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian shpjeguan se ishin të mbytur nga vështirësitë me të cilat përballen dhe se shpesh u vihet faji atyre vetë që kanë mbetur të margjinalizuar. Ata na treguan këndvështrimet e tyre:

Ata [burrat] pijnë për shkak të stresit. E shohin që nuk mund të sigurojnë jetesën e familjeve të tyre.

Ai mund të ketë 30-40 mijë lekë dhe i harxhon të gjitha. I them, pse? Pse nuk i kursen këto lekë? Mund t'i harxhosh për fëmijët e tu. Ai më kthehet e më thotë: nuk mund ta ndryshoj jetën time me kaq para.

Ata të gënjejnë sepse nuk kanë besim tek ti.

Dua të të garantoj se ata nuk janë të interesuar të mbledhin mbeturina. Ata duan të punojnë dhe të kenë një punë të qëndrueshme. Po ku? A do të mblidhnin mbeturina po të kishin qenë dembelë?

Pjesa vijuese përqendrohet tek mënyra se si ndërvepron kurthi i varfërisë me atë të shëndetit.

Kurthi shëndetësor

Romët dhe egjiptianët jetojnë me probleme të shumëfishta të shëndetit fizik dhe mendor. Problemet e shëndetit fizik dhe mendor ndërvepronin me njëri tjetrin, duke e thelluar më tej varfërinë dhe përjashtimin social. Zakonisht, shpenzimet për shëndetin janë më të mëdha se shpenzimet për ushqime. Vetëm pak individë arrijnë të blejnë barna. Shumica merrnin barna vetëm në raste urgjence, ndihmoheshin nga fqinjët dhe të afërmit, ose nuk merrnin fare mjekim. Në spitale dhe qendra shëndetësore u identifikuan praktikatat e mëposhtme diskriminuese: mospranimi, trajtimi i pabarabartë, keqtrajtim, dhe segregim. Mjekët dhe profesionistët e shëndetit përdorin gjuhë ofenduese. Pjesëmarrësit në studim kishin njohuri shumë të pakta për problemet shëndetësore. Qasja e tyre në shërbimet shëndetësore lehtësohej nga punonjësit e komunitetit, të cilët shpesh e përshkruanin sjelljen e romëve dhe egjiptianëve të varfër si të pakuptueshme.

Familjet rome dhe egjiptiane jetojnë me probleme të shumëfishta shëndetësore. Ato raportuan infeksione gastro-intestinale, ulcera, tension të lartë të gjakut, dhimbje koke, probleme me shikimin, astmë, diabet, epilepsi, probleme të lidhura me veshkat, veshët dhe zemrën. Po ashtu të zakonshme ishin edhe problemet e shëndetit mendor. Intervistat treguan për simptoma depresioni, si të ndërjerit i/e pavlerë dhe pa shpresë, pesimizmi, pagjumësia dhe trishtimi. Disa shembuj renditen më poshtë:

Natën nuk më zë gjumi. Mendoj për të nesërmen. Çfarë do të bëj nesër? Ku do të punoj? Ne mundohemi të gjejmë punë. Kur vijmë në shtëpi përpiqemi të blejmë ç'të mundim me ato që kemi fituar. Shtëpia ka nevojë për miell, të pastrohet, shumë gjëra. Nuk më del për të blerë asgjë.

Më del gjumi në 4 të mëngjesit dhe mendoj se çfarë do të bëj. Sot, për shembull, i kam fëmijët sëmurë. Si do t'ia bëj? Ku të shkoj?

Unë kam tension të lartë të gjakut. Jam në moshë. Çfarë të bëj? Ja këtu jetoj. Jeta është e vështirë ... Jetoj me halle. Kam rritur fëmijët e djalit; janë jetimë. Jam e mërzitur edhe për djalin. Ai është i sëmurë. Tjetri jeton në kushte të vështira. Kam kaq shumë probleme.

Atë [djalit] e shtypi makina dhe që atëherë vetëm bërtet. Bërtet gjithë kohën, gjithandej. Të vegjlit janë të mërzitur. Ai u bërtet atyre dhe ata frikësohen... Unë i mbaj pranë vetes, po ata kanë frikë.

Ishin të shumta rastet e familjeve ku pothuaj të gjithë anëtarët vuanin nga probleme shëndetësore. Flora kishte probleme me veshkat, veshët, dhe zemrën. Kishte edhe astmë. Nëna e saj kishte kancer, kurse i ati diabet. Djali më i madh ishte me astmë dhe probleme të zemrës, ndërsa më i vogli vuante nga epilepsia. Vjollca vuante nga ulcera, tensioni i lartë të gjakut, dhe probleme të zemrës. Vajza e vogël i vuante nga migrena. Yllka më tregoi listën e barnave që duhet të merrte. Pastaj tha:

Unë s'i kam bërë të gjitha analizat, por ajo që di është se kam dhimbje koke gjithë ditën. Për shkak të problemeve të tiroideve, m'u shfaq edhe një gjë më e keqe, diçka shumë e keqe. Doktorët mendojnë se vuaj nga diçka vërtet e keqe. Veshkat po më lënë. Kam edhe astmë.

Problemet e shëndetit mendor vijnë zakonisht nga trauma të papritura shëndetësore. "Kur filluan të gjitha këto probleme?", e pyeta Yllkën.

Kur m'u sëmur vajza. Kam kohë që jam me depresion. Për gjashtë muaj kam qenë e paralizuar. Mora ilaçe për një vit dhe pastaj nuk mora më. Nuk i blija dot. Ishin shumë të shtrenjta.

Vera kishte vënë re një lidhje shkakore ndërmjet procesit të kërkimit nëpër kazanët e plehrave dhe problemeve shëndetësore: "Vjehri pati atak në zemër. Ai mbledhte mbeturina, gjë që sjell infeksione gastro-intestinale. Por nuk kishte zgjidhje tjetër. Duhet të mbledhte mbeturina." Në mënyrë të ngjashme, një e intervistuar tjetër tregoi se fëmijët e saj u sëmurën pasi filluan të lypnin nëpër rrugët e Kosovës. Të intervistuar të tjerë folën për lidhje shkakore ndërmjet kushteve të rënda të jetesës dhe problemeve shëndetësore, si për shembull përmbytjet dhe ethet.

Shpesh shpenzimet shëndetësore ishin shumë më të mëdha se shpenzimet për ushqime. "Sa harxhoni për problemet shëndetësore çdo muaj?" e pyeta një nga të intervistuarat. "Mijëra lekë. Mos më pyet. Ne harxhojmë 300-400 mijë lekë. Ilaçet janë shumë të shtrenjta. Megjithëse punojmë, nuk kursejmë dot gjë." Vetëm një numër i vogël familjesh arrinin ta përballonin blerjen e barnave. Të tjerat merrnin barna vetëm në raste urgjence, ose ndihmoheshin nga fqinjët dhe të afërmit, ose nuk merrnin fare barna. Liza na tregoi një listë të gjatë të problemeve të saj shëndetësore. "Si i përballon shpenzimet mjekësore?" e pyeta. M'u përgjigj duke thënë:

Nuk i marr fare ilaçet. Vetëm ilaçi i stomakut bën 40 mijë lekë; ai i tensionit të gjakut kushton 18- 19 mijë. Por nuk i përballoj dot. Marr ndonjë kokërr ose dy kur jam shumë e sëmurë, ose i kërkoj ndihmë fqinjës kur më merren mendtë. Të them të drejtën, nuk ma mban xhepi t'i blej.

Shpesh kursimet zhduket për shkak të të papriturave shëndetësore. Lindita kishte kursyer 200 mijë lekë gjatë gjashtë muajve të parë të punës. Por 185 mijë prej tyre i harxhoi për të mjekuar një sëmundje që iu shkaktua nga kushtet e vështira të punës.

Megjithatë, rimëkëmbja e shëndetit nuk ka të bëjë vetëm me marrjen e barnave, por, ndër të tjera, edhe me të ushqyerit e shëndetshëm, Personat e intervistuar treguan se nuk ia dilnin dot të hanin ushqime të shëndetshme. Gjatë shpjegimit të problemeve shëndetësore

të anëtarëve të familjes së saj, një nënë e re tha: "Po vuaj shumë me të voglin. Nuk jemi në gjendje ta çojmë në spital. Ai ka nevojë për ilaçe, çaj, lëngje. Ka nevojë edhe për fruta. Por nuk jemi në gjendje t'i përballojmë të gjitha këto. Është shumë e vështirë."

Ndërveprimet e romëve dhe egjiptianëve me mjekët dhe profesionistët e shëndetit kontribuojnë në vazhdimësinë e përjashtimit social. Ata refuzohen si në mënyrë aktive (p.sh. duke i trajtuar keq, ose duke u tallur e përbuzur), ashtu edhe në mënyrë pasive (p.sh. duke i shpërfillur). U identifikuan praktikatat e mëposhtme diskriminuese dhe përjashtuese: mospranimi, trajtimi i pabarabartë, keqtrajtimi, dhe segregimi. Mjekët dhe profesionistët e shëndetit përdornin gjuhë fyese. Më poshtë vijojnë disa shembuj të përmendur nga personat e intervistuar:

Djali kishte temperaturë të lartë. Shkuam në spital po askush nuk e preku me dorë.

E çuam vajzën në spital. Ajo ishte gati për të lindur dhe ata as nuk e prekën me dorë. Thanë se do të lindte vetë, dhe as nuk e prekën. Nuk u kujdesën për të. Ata e shkatërruan. Nuk e di se si mbeti gjallë.

I thashë doktorit se kur të bëhej mirë fëmija, e di se çfarë do bëj. Tani s'bëj dot asgjë. Pse? Se jam i zi, kurse ti je e bardhë. Për spitalin nuk duhet të ketë rëndësi a je i bardhë a i zi. Një Zot i ka krijuar të gjithë!

Vera tregoi përvojën e saj:

Para dy vjetësh, e kishim mbesën në spital... mora ca ushqime për të dhe u nisa për spital. Kur hyra tek dhoma e saj, pashë se infermierja ia kishte bërë krahun copë. Nuk ia gjenin dot venat dhe nuk ndalonin së nguluri gjilpërat. Fëmija po mbytej nga gjaku... Më hyri frika, më hyri frika. U thashë: "Do shkoj tek drejtori. Çfarë po i bëni kësaj fëmije? ... Ka pasur raste të tjera kur i kam çuar fëmijët e mi në spital dhe na ndanin veç nga njerëzit e tjerë. Shihnin të gjenin dhoma të veçanta, se të tjerët nuk donin të rrinin në të njëjtën dhomë me ne.

E ngrite zërin? A u ankove për këtë? e pyeta.

Ku? Doktorit duhet t'i dijë rregullat e spitalit. Po kështu edhe infermieret. Ku? Ato ishin të parat që e ndërjuan dhomën. Puna është se kur shkon në spital, duhet të të respektojnë. Ata duhet të na kuptojnë ne... Ne bëjmë çfarë kemi në dorë. Vishemi mirë. I respektojmë. Edhe ata duhet të na respektojnë ne. Ka kaq shumë gjëra. Ç'të të them? Jemi pa shpresë!

Shumë të intervistuar shpjeguan se qëndrimet e mjekëve dhe profesionistëve të tjerë të shëndetit ndikohen nga pamundësia e tyre për të paguar. Gëzimi diskutoi një përvojë të tijën të kohëve të fundit në spital:

Po nuk i pagove, s'të prekin me dorë. Të çojnë nga një dhomë në tjetrën. Para një jave isha në spital. E pritëm doktorin më shumë se një orë. Pse duhet të ndodhë kështu? Pse duhet të veprojnë në këtë mënyrë? Apo ngaqë jemi romë? Pse duhet të bëjnë dallim? Të gjithë jemi njerëz.

Personat e intervistuar treguan se kishin njohuri të dobëta të problemeve shëndetësore. Ja se si i shpjegoi një nënë egjiptiane problemet shëndetësore të fëmijës së saj: "Ai kishte një gjë në tiroide. Para ca vjetësh e bënë operacion. Diçka nuk shkoi mirë dhe atyre iu desh të ndryshonin diçka." Kur i kërkova të më jepte më shumë hollësi, ajo mblodhi supet.

Shpesh, qasja e prindërve në spitale dhe qendra shëndetësore lehtësohej nga punonjës të komunitetit që i karakterizonin sjelljet e romëve dhe egjiptianëve si të pakuptueshme. Pse na kërkojnë ndihmë ne? Pse nuk i çojnë vetë fëmijët në spital? Pse fëmija ka thyer krahun dhe e ëma nuk e çon në spital?

"Pse shkove tek shoqata për ndihmë?", e pyeta Verën. "Mund ta kishe çuar vetë fëmijën në spital." Ja si m'u përgjigj Vera: "Po ta kisha çuar vetë djalin [me krahun e thyer] në spital, ata s'kishin për ta prekur me dorë. Do të më kërkonin radiografi, fasha, ilaçe. Do të më thoshin blej këtë e blej atë. Prandaj erdha tek organizata." Vera duhet të zgjidhte midis pagimit të qirasë dhe mbulimit të shpenzimeve shëndetësore. "Po nuk e pagova qiranë, do të më nxjerrin jashtë." Duke shkuar tek shoqata, ajo shmangte pagimin e të gjitha shpenzimeve – transportit, trajtimit mjekësor, dhe barnave. Përveç kësaj, ajo shmangte edhe ndërveprimin me profesionistët e shëndetësisë. Kur punonjësi i komunitetit i kërkoi të shkonte me të në spital, ajo i tha që nuk ndihej mirë. Nuk ja tregoi arsyen e vërtetë.

Një punonjës tjetër komuniteti foli për një përvojë të tij të kohëve të fundit me një prind, që doktori e kishte këshilluar ta linte fëmijën në spital, por nëna e fëmijës kishte vendosur ta nxirrte nga spitali. Ai tha: "Nuk i kuptoj këta njerëz. Doktorit i tha asaj [nënës] ta linte djalin në spital, por ajo nuk e mori parasysht çfarë i tha ai. Çfarë të bëj unë? S'ia mbush dot mendjen nënës me zor. Herën tjetër që do ta takoj doktorin, ka për të më thënë mos më shqetëso më." Unë e intervistova nënën dhe e pyeta për vendimin që kishte marrë. Ajo më tha: "Doktori më tha se djali kishte nevojë për shërbim intensiv. Nuk mund ta lija atje se kisha edhe një fëmijë tjetër të sëmurë në shtëpi. Kush do të kujdesej për të?" Duke e nxjerrë djalin nga spitali, ajo mund të kujdesej për të dy fëmijët.

Pjesa më e madhe e nënave thanë se vuanin nga depresioni dhe ndiheshin pa shpresë. Ata donin që mjekët dhe profesionistët e shëndetësisë të ishin më të vëmendshëm ndaj nevojave të tyre, siç këshilloi një nga nënat egjiptiane:

Dëgjoje se çfarë ka për të thënë. Dëgjoji mendimet e saj. Respektoji ato. Nëse shikon që diçka nuk shkon mirë, të lutem ki pak durim. Mos e ngri zërin; mos ulërit. Ne kemi vuajtur shumë; na mbytën ankthet. Mund të bëjmë ndonjë gabim, se nuk i dimë ca gjëra, po duhet të na tregojnë. Nëse silleni mirë me ne, ne ndihemi të lehtësuar.

Ato [nënat egjiptiane] kanë vuajtur shumë. Ato kanë vuajtur shumë sepse nuk kanë strehim, nuk kanë punë, fëmijët i kanë të sëmurë. Disa nga nënat nuk trajtohen mirë nga burrat e tyre dhe nuk e dinë ku ta shprehin atë që ndiejnë.

Kurthi arsimor

Shpenzimet arsimore ushtrojnë një trysni të madhe në buxhetin e familjeve dhe shumica e tyre nuk mund t'i përballonin ato. Të mbijetosh do të thotë të përqendrohesh në nevojat e ngutshme dhe, si rrjedhojë, investimet afatgjata, si arsimi, perceptohen se nuk kanë ndonjë vlerë të madhe. Romët dhe egjiptianët e varfër nuk mund të shpëtojnë nga kurthi arsimor në kushtet e një mjedisi shkollor përjashtues. Mësuesit e lehtësonin përjashtimin social përmes segregimit, përdorimit të gjuhës fyese, diskriminimit në vlerësimet me nota, dhe keqtrajtimet. Familjet që kishin dalë nga kurthi arsimor, ose që ishin duke dalë prej tij, jetonin në lagje të përziera, kishin burime financiare të sigurta, strehim të sigurtë, dhe të paktën një nga prindërit kishte një farë niveli arsimor. Prindërit e arsimuar u kërkonin llogari mësuesve dhe kërkonin drejtësi për fëmijët e tyre. Prindërit përdornin strategji të shumta për të këputur zinxhirët e diskriminimit dhe për të dalë nga kurthi arsimor. Masa në të cilën ishin të suksesshëm varej nga faktorë si individualë, ashtu edhe mjedisorë.

Prindërit e varfër a duhet t'i çojnë fëmijët në shkollë, apo të vënë ushqim në tryezë? Shpesh, ata zgjedhin këtë të dytën. "E pse ta çoj fëmijën në shkollë?", tha një prej prindërve. "Po të lypë, ajo ka për të fituar 10-15 mijë lekë." Prindërit e kishin shumë shqetësim çështjen e shpenzimeve për arsimin. Më poshtë vijojnë disa prej shpjegimeve të tyre:

Ata duan të shkojnë [në shkollë] por unë nuk jam në gjendje ... Jam munduar shumë. Të paktën nuk shkojnë të flenë pa ngrënë.

Djali im e la shkollën. Nuk kishim bukë të hanim, kështu që ai na ndihmonte të mbledhnim shishe plastike dhe gjëra të tilla. Unë lypja dhe ai sille rrotull. E njëjta gjë dhe me vajzat.

Unë nuk i plotësoja dot nevojat e fëmijëve të mi. Prandaj edhe nuk kanë bërë ndonjë shkollë të madhe. Duhet t'u blija libra dhe gjëra të tjera dhe ne nuk i paguanim dot. Të tjerët kishin këpucë të mira, rroba me të mira, çanta më të mira, kështu që fëmijët e mi nuk shkuan. Unë u thosha të shkonin, dhe prapë nuk shkonin ... Çfarë të bëja: të paguaja qiranë, apo të blija ushqime?



Unë doja që fëmijët e mi të shkonin në shkollë, por gjithë puna është tek lekët. Unë nuk i çoja dot në shkollë sepse duhet t'u blija libra, fletore, etj., dhe nuk isha në gjendje t'u blija.

Problemi nuk ka qenë se fëmijët e mi nuk kishin dëshirë të shkonin në shkollë. Ishte çështje lekësh. Unë s'i çoja dot në shkollë sepse duhet t'u blija libra, fletore, e gjëra të tjera, dhe nuk isha në gjendje.

Prindërit theksuan se sa e rëndësishme ishte për ta që fëmijët e tyre të trajtoheshin në mënyrë të barabartë me të tjerët. Një nga prindërit, një nënë e vetme, nuk ishte në gjendje të paguante uniformën e shkollës. Megjithatë, ajo nuk u dorëzua:

Prindërit e tjerë i kanë paguar me kohë uniformat. Unë i kërkoja mësueses dhe drejtores së shkollës që ta mbanin shënim emrin tim. S'mund ta përjashtoj fëmijën nga nxënësit e tjerë të klasës. Në qoftë se fëmija nuk ndihet i barabartë, atëherë nuk ka për të dashur të lexojë e të shkruajë.

Një prind tjetër tregoi diçka të ngjashme:

Fqinja ime nuk donte ta çonte vajzën në shkollë, megjithëse vajza kishte dëshirë të shkonte. Ajo nuk kishte lekë t'i blinte këpucë, bluzë, dhe rroba të tjera... A mund ta çosh fëmijën në shkollë kur bie shi dhe fëmija nuk ka xhup? ... Po shkoi vajza në shkollë me rroba të vjetra, të tjerët do ta tallin. Prandaj nuk i çojmë fëmijët në shkollë.

Prindërit raportuan se fëmijët e tyre kanë më shumë gjasa të mos shkojnë në shkollë gjatë dimrit. Ata i mbajnë fëmijët në shtëpi sepse nuk janë në gjendje t'u blejnë rroba dimri, të cilat janë zakonisht më të kushtueshme se rrobat e verës. Kështu, frekuentimi i shkollën nga ana e tyre ndjek një model sezonal.

Përveç faktit që u mungonin mjetet financiare për të arsimuar fëmijët e tyre, prindërit mendonin se arsimi kishte shumë pak, ose aspak përfitim për ta. Një nënë e re tha: "Ne duam që fëmijët tanë të shkollohen, por shkollimi nuk ndryshon gjë." Astriti kishte dy diploma të shkollës së mesme. I zhgënjyer, ai tha: "Shkolla nuk më ka hyrë në punë për asgjë."

Arritjet e fëmijëve në mësimet varen shumë nga ç'ka ata mësojnë në shkollë. Por çfarë ndodh pas shkollës? A mësojnë fëmijët në shtëpi? Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje – në të gjitha rastet – ishte 'jo'. Për këtë jepeshin dy shpjegime kryesore. Shpjegimi i parë ishte se mjedisi familjar nuk i nxiste fëmijët të mësonin. Fatimja kishte një dhomë së bashku me tre gjyshërit e saj dhe me dy djem – një nga ata vuante nga një sëmundje e rëndë mendore. Përveç kësaj, në dhomë nuk kishte as tavolinë e as karrige. Ajo i përshkroi nipërit e saj si tejet të stresuar dhe hiperaktivë. "Fëmijët e mi kanë nevojë për një trajtim të veçantë në shkollë," tha ajo, shumë e shqetësuar.

Ata nuk përqëndrohen dot. Pastaj, ajo shtoi: "Ata nuk mësojnë. Ata kanë nevojë për vëmendje të veçantë. Dikush duhet të kujdeset për ta." Shpjegimi i dytë është se prindërit analfabetë nuk mund t'i ndihmojnë fëmijët me detyrat e shkollës. "A mund t'i ndihmosh fëmijët për të bërë detyrat e shtëpisë?", e pyeta një nga të intervistuarat. "Jo, nuk mundem. Unë s'kam qenë kurrë në shkollë. Burri im po ashtu." Në mënyrë të ngjashme, kur e pyeta një nënë të re nëse e ndihmonte vajzën me detyrat e shtëpisë, ajo më tha, "Nuk di si ta ndihmoj."

Megjithëse prindërit e paarsimuar nuk mund t'i ndihmonin fëmijët e tyre, ata e kuptonin dhe theksonin nevojën e arsimit. Lulja tha se i vinte keq që e kishte lënë shkollën: "Po të kisha pasur shkollë, do të kisha pasur çdo gjë. Nuk do të vuaja siç po vuaj tani. Do të kisha gjetur një punë. Do të kisha ditur si të jetoj. Unë po vuaj sepse mora vendimin e gabuar për ta lënë shkollën."

Mjedisi shkollor i hap rrugën përjashtimit social. Personat e intervistuar na treguan për raste kur mësuesit dhe nxënësit e tjerë i kishin trajtuar keq dhe i kishin tallur. Kishte disa raste të intervistuarish që thanë se vendimi për të lënë shkollën ishte ndikuar nga qëndrimet dhe sjelljes e mësuesve dhe të nxënësve të tjerë. Mësuesit e ndihmonin përjashtimin social përmes segregimit, përdorimit të gjuhës ofenduese, dhe diskriminimit në vlerësim me nota. Shpesh këto praktika ndërvepronin me njëra-tjetrën. Një nënë rome na foli për përvojën e saj:

Mësuesja e ndante vajzën time veç nga pjesa tjetër e klasës. Vajza vinte në shtëpi dhe më thoshte se nuk donte të shkonte në shkollë. Ajo [mësuesja] i thoshte "vetëm ti..." Unë shkova në shkollë dhe e takova mësuesen. I thashë: dëgjo, dua të bisedoj me ty. Ti je mësuesja e vajzës sime për katër orë; për ato katër orë ti do të jesh nëna e saj. Dua të më thuash se cila është arsyeja që vajza ime nuk ka qejf të vijë në shkollë ... U takova me drejtoreshën e shkollës dhe e pyeta: A je raciste? I thashë: Dëgjo, vajza ime i ka të gjitha sa i duhen për të qenë në shkollë. Mua më ndihmon një organizatë. Po bëj çështje e mundur që ta mbaj në shkollë. Ajo më tha: Ju romët gjithmonë kështu keni qenë. Domethënë ti qenke raciste, i thashë. Dëgjo, i thashë, ti nuk je më e mirë se unë. Ika nga shkolla dhe i thashë vajzës: Nëse mësuesja të godet apo të fyen, mos i thuaj asgjë. Ajo është shumë e ndjeshme, dhe qan tërë kohën. Dy ditë pas kësaj, mësuesja e goditi me laps në kokë.

Përveç segregimit dhe ngacmimeve, prindërit raportonin diferencim në nota dhe përdorimin e gjuhës fyese, siç e tregojnë dy shembujt e mëposhtëm:

I kërkova asaj [mësueses] që të vija të dëgjoja një orë mësimi. Vëzhgova një fëmijë të bardhë duke lexuar, si dhe vajzën time duke lexuar. Vajza ime lexoi rrjedhshëm ndërsa ai fëmija i bardhë mezi lexonte. Vajza ime mori pesë, kurse fëmija i bardhë mori tetë.

Një mësuese e pyeti vajzën time, mos je jevgë ose gabele? Ajo më tha: "Kur ma bëri mësuesja këtë pyetje, unë s'e desha veten. Ula kokën dhe nuk fola." Pastaj ajo kishte filluar të qante sepse nxënësit e klasës filluan të talleshin me të. Shkova tek drejtori i shkollës dhe u zura me të.

Një nga veprimtarët e komunitetit na tregoi për shembullin e një fëmije që e kishin poshtëruar në sy të bashkëmoshatarëve të tij. Mësuesja i kishte thënë: "T'i mban erë të keqe. Shko në shtëpi dhe lahu!" "Kur vërejtje të tilla bëhen para klasës, ia ke shkatërruar plotësisht imazhin fëmijës," tha një aktivist. Të intervistuar të tjerë treguan për raste kur bashkëmoshatarët e klasës i kishin ngacmuar dhe tallur fëmijët e tyre në shkollë.

Me gjithë këto vështirësi, prindërit ishin të përkushtuar ndaj arsimit të fëmijëve të tyre. Shumë prindër treguan për shpresat dhe aspiratat e tyre:

Do të bëj çështje e mundur. Nuk dua që fëmijët e mi të vuajnë siç kam vuajtur unë. Dua që ata të kenë mundësi më të mira.

E vetmja shpresë që kam është që nipërit e mbesat e mia të shkollohen.

Unë s'kam pyetur për nevojat e mia, me qëllim që të plotësoja nevojat e fëmijëve të mi. Nëse e çon fëmijën tënd në shkollë, do që ai të jetë në pozita të barabarta me të tjerët. Nuk do që fëmija yt të jetë i izoluar; nuk do që fëmija yt të ndihet ndryshe.

Prindërit përdorin strategji të shumta për të këputur zinxhirët e diskriminimit dhe për të dalë nga kurthi arsimor. Një nga prindërit shpjegoi se: "Në qoftë se mësuesja e merr vesh që fëmija im është rom, atëherë ka për t'i vënë nota të ulëta. Për ta shmangur këtë, unë i kërkoj dikujt nga puna ku punoj që të shkojë në takimet me prindër." Një nga baballarët tha se ai enkas nuk shkonte në takimet me prindër. "Në qoftë se të tjerët e marrin vesh që fëmija im është i varfër, atëherë do ta lënë pas dore," tha ai.

Disa nxënës kishin rezultate më të mira në shkollë se të tjerët. Prindërit, punonjësit dhe aktivistët e komunitetit dhanë shpjegimet e mëposhtme për suksesin e tyre: (a) familja banon në një lagje të përzier; (b) të paktën një nga prindërit ka një farë niveli arsimor; (c) familja ka qasje në strehim të sigurtë; (d) familja ishte në gjendje të paguante shpenzimet shëndetësore; dhe (e) babai nuk ishte i alkoolizuar. Prindërit që kishin një farë niveli arsimor na treguan shembuj se si kishin shkuar në shkollë dhe i kishin vënë mësuesit para përgjegjësisë. Ata e ngrinin zërin më shumë se të tjerët.

Prindërit që kishin investuar në arsimimin e fëmijëve të tyre ishin mjaft të shqetësuar për përfitimet që vijnë nga arsimi. Siç e shpjegojmë më poshtë, diskriminimi perceptohet si barriera kryesore ndaj pjesëmarrjes dhe integritetit të romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës.

Kurthi i punësimit

Punësimi dhe programet e formimit profesional theksojnë rëndësinë e integritetit të romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës (Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2015). Ky studim tregon se tregu formal ndihmon në përjetësimin e përjashtimit social të romëve dhe egjiptianëve përmes mekanizmave të shumta, si pagat e ulëta dhe vonesat në dhënien e pagës, si dhe qëndrimet diskriminuese. Pjesëmarrësit në studim e përshkruan diskriminimin si barrierën kryesore ndaj pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës. Edhe kur kishin ndonjë farë niveli arsimor, ata nuk mendonin se kishin pasur ndonjë përfitim të madh prej tij. Mungesa e

lidhjeve dhe rrjeteve ndihmon përjetësimin e gjendjes së disavantazhit ekonomik.

Një koncept i gabuar mjaft i përhapur është se romëve dhe egjiptianëve nuk u pëlqen puna. Ky koncept u kundërshtua nga anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian. Një nga të intervistuarit tha: "Unë dua t'ju garantoj se ata nuk janë të interesuar të mblidhin plehra. Ata duan të punojnë dhe të kenë një punë të qëndrueshme. Po ku? Do të mblidhnin plehra po të ishin dembelë?" Ekzistonte një perceptim i përgjithshëm se shpërndarja e punëve bazohet tek lidhjet personale dhe politike. "Neve na trajtojnë ndryshe," tha Astriti. "A mund të na japësh një shembull se është trajtimi ndryshe?" e pyeta. "Ai fillon kur pesë vetë aplikojnë për një vend pune dhe vetëm njëri punësohet. Ai që e merr punën nuk është nga komuniteti ynë."

Tregu formal i punës paraqet pesë rreziqe për romët dhe egjiptianët. Së pari, vonesat në dhënien e pagave. Pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve në tregun formal të punës nuk garanton siguri. Një nga të intervistuarat bënte pjesë në tregun formal të punës. Megjithatë, ajo nuk e merrte pagën në kohë. Ja si e shpjegoi ajo ndikimin e vonesës në dhënien e pagave:

U zgjova në mëngjes dhe shkova tek dyqani. Ajo [pronarja] më tha: të është shtuar borxhi. Kur do ta shlyesh? Po ta marr rrogën, e paguaj borxhin. Kjo është që më shqetëson. Ka katër muaj që s'marr rrogë... Ngaqë jam e mërzitur, filloj e i bërtas e ulërij fëmijëve. Edhe gjithë kjo sepse nuk jam në gjendje të paguaj.

Së dyti, pagat janë të ulëta. Kur po diskutonim për vështirësitë që hasin të rinjtë e të rejtat rome në tregun e punës, një nga të intervistuarit m'u kthye dhe më tha: "A jeton dot ti me 200 mijë lekë në muaj? Mendoje si për veten tënde. A do të të mjaftonin? Po sikur të kishe gjashtë fëmijë?"

Së treti, pamundësia për të plotësuar nevojat e përditshme. Për të varfrit, të ardhurat ditore janë më të rëndësishme se ato mujore. Ata nuk mund të mbështeten në prona dhe kursime. Nëse nuk marrin të ardhurat në fund të ditës, atëherë shkojnë të flenë në darkë të pangrënë. Astriti kishte ndjekur një kurs formimi profesional, por e kishte pasur shumë të vështirë ta përfundonte:

Unë shkova në kurs për gjashtë muaj. Po shkonte shumë mirë, por kur shkon në kurs, duhet të mendosh edhe për gjëra të tjera. Duhet të gjesh një punë të qëndrueshme dhe të sjellësh të ardhura në familje. Shkon shumë gjatë të presësh për pagën në fund të muajit. Të duhen të ardhura për të ushqyer familjen. Përndryshe nuk ke si mbijeton.

Personat e intervistuar bënin punë të rënda që ua dëmtonin shëndetin. Një grua e re përshkroi një përvojë të shkurtër pune të sajën si vijon:

Punoja për një kompani që mblidhte shishe plastike. Paga ishte e mirë. Merrja 300 mijë lekë në muaj; 10 mijë lekë në ditë. Puna fillonte në orën shtatë të mëngjesit dhe mbaronte në pesë e gjysmë pasdite. Era ishte e tmerrshme. Ne punonim jashtë gjithë ditën – në shi e në diell.

Së katërti, ndërprerja e ndihmës ekonomike. "A ka ndjekur burri yt ndonjë kurs formimi profesional?" E pyeta një grua të re. Ajo u përgjigj duke thënë: "Po të gjejë punë [në tregun formal të punës], atëherë nuk na japin më ndihmë ekonomike."

Së pesti, kohëzgjatja e shkurtër e punësimit. Vendet e punës në tregun formal zakonisht perceptohen si të pasigurta. Romët dhe egjiptianët mund të diskriminohen, të trajtohen keq, ose të pushohen nga puna.

Për shkak të ekzistencës së diskriminimit, personat e intervistuar nuk shihnin ndonjë përfitim të madh nga arsimi. "Ne kemi trajnuar djem dhe vajza," tha një punonjëse e komunitetit. "Kanë marrë çertifikata si parukiere, berberë, etj., por kjo nuk ka pasur ndonjë rezultat. Urime për certifikatën, por ajo nuk hyn në punë për asgjë!"

Disa nga personat e intervistuar kishin ndjekur kurse të formimit profesional. Megjithatë, asnjë prej tyre nuk kishte gjetur punë. Artani foli për përvojën e të birit:

Djali im ndoqi një kurs formimi profesional.

Mund të më tregosh pak më shumë për kursin? e pyeta.

Ai mbaroi një kurs për panelet diellore.

Ka gjetur punë?

Jo, s'ka gjetur punë.

Cila është arsyeja, sipas mendimit tënd?

Ata i thonë se është [pauzë] gabel. Do të na vjedhë pajisjet, do na bëjë ndonjë gjë. Ata nuk na besojnë ne. Duhet të na japin një herë një mundësi, e pastaj të shohin se çfarë do të bëjmë. Në vend të kësaj, ata t'i ngulin sytë, të shohin ngjyrën e lëkurës e rrobat që ke veshur.

Një prind tjetër na tregoi një përvojë të ngjashme me djalin e tij:

Djali im mbaroi një kurs formimi profesional. Mori diplomën, po s'ka pasur asnjë ofertë për punë. Ai është regjistruar në zyrën e punës dhe shkon atje shumë shpesh, por s'ka dëgjuar gjë prej tyre. As unë s'kam dëgjuar gjë prej tyre. Prandaj punojmë në tregun e zi.

Romët dhe egjiptianët e varfër nuk kanë lidhje dhe rrjete shoqërore që mund të lehtësojnë mobilitetin ekonomik dhe social të tyre. Një nga personat e intervistuar tha: "Njerëzit e tjerë mbështeten tek njëri-tjetri, ndihmojnë njëri-tjetrin. Ndërsa me ne kjo nuk ndodh, sepse neve na shohin si qytetarë të dorës së dytë. Është shumë e vështirë."

Punonjësit e komunitetit na treguan se përpjekjet e tyre për të lidhur romët dhe egjiptianët e papunë me zyrat e punës nuk kishin pasur asnjë dobi. Romët dhe egjiptianët nuk tregonin

interes për zyrën e punës. Edhe kur zyra e punës i merrte në telefon, ata nuk i përgjigjeshin telefonit. Për ta kuptuar më mirë këtë, e pyeta një nga të intervistuarit: "Punonjësit e zyrës së punës ankohen se edhe kur i marrin njerëzit në telefon dhe i lidhin me vende pune, ata nuk përgjigjen. Pse mendoni se ndodh kështu?" Ai tha:

Nuk u pëlqen rroga. Ndoshta do të merrnin pesë mijë lekë të vjetra në ditë, ose 150 mijë lekë në muaj. Nuk mund ta përballojnë dot jetesën me aq para. Të punosh shtatë apo tetë orë për pesë mijë lekë, ndërkohë që mund të marrësh dhjetë mijë në ditë kur punon në tregun e zi.

Gruaja e tij shtoi:

Duhet të mendosh për të gjitha problemet; pesë mijë lekë nuk mjaftojnë. Nuk dalin as për të blerë ushqime, e le më pastaj për të përballuar shpenzimet shëndetësore apo për të blerë sandale për fëmijët.

Në pjesën në vijim diskutojmë se si janë zënë romët dhe egjiptianët në kurthe institucionale që ndihmojnë në vazhdimësinë e përjashtimit të tyre nga tregu i punës dhe nga sektorë të tjerë.

Kurthi institucional

Romët dhe egjiptianët janë zënë në kurthin institucional, nga institucione që ndihmojnë në vazhdimësinë e diskriminimit, tëhuajzimit, dhe përjashtimit.

Plotësimi i numrit të pikëve

Një nga shqetësimet e ngritura nga personat e intervistuar ishte se ata mbetën duke hyrë dhe dalë nga programet e ndihmës ekonomike. "Ndonjëherë marrim ndihmë ekonomike, ndonjëherë jo... Ne duam të hamë më shumë, por nuk jemi në gjendje t'i përballojmë. Jemi në një gjendje shumë të keqe," tha një nga të intervistuarit. "A ju kanë dhënë ndonjë shpjegim se pse jua kanë hequr emrin nga programi i ndihmës ekonomike?", e pyeta. Ai u përgjigj duke thënë:

Na thanë që nuk përfitojmë sepse nuk plotësojmë numrin e pikëve. Çfarë lloj pikësh duhet të plotësoj? Unë jam pa punë. Edhe gruaja, po ashtu, është pa punë... Unë jam regjistruar në zyrën e punës... Çfarë lloj mbështetjeje më jep ti mua si qeveri? Ju po më zhysni edhe më thellë. Po nuk pata punë, do përfundoj duke vjedhur, vrarë njerëz, duke mashtruar. Do të përfundoj që do bëj diçka.

Zana nuk e kishte të qartë pse i biri nuk përfitonte ndihmë ekonomike: "Atë e hoqën nga programi, nuk e di pse. Thanë që tani është më mirë, po unë nuk mendoj ashtu. Si nënë, unë

e kuptoj fëmijën tim shumë mirë. Unë nuk mendoj se ai është bërë më mirë." Një punonjës i komunitetit tha se ai dhe kolegët e tij i ndihmojnë familjet e varfra që të mbledhin dhe dorëzojnë të gjitha dokumentet e nevojshme në zyrat bashkiake. E vetmja përgjigje që marrin është se "nuk i kanë plotësuar pikët." Për të marrë më shumë informacion, ata mbështeten tek lidhjet personale që kanë në drejtoritë bashkiake.

Gjatë diskutimit të heqjes së tyre nga programi i ndihmës ekonomike, të intervistuarit bënë krahasime me të tjerët dhe vunë në dukje pafuqishmërinë e tyre. Gëzimi tha:

Unë punoj për një person që merr ndihmë ekonomike. Ai ka një biznes; ka shtëpi, ka makinë. Unë punoj për të dhe nuk marr ndihmë ekonomike. Ai më jep pesë mijë lekë, dhe merr asistencë. Ata [zyrtarët] duhet t'i zgjidhin këto gjëra. Na duhet një zyrë ku mund t'i shprehim këto probleme dhe të gjejmë zgjidhje.

Ata [zyrtarët qeveritarë] thonë, "egjiptian është ai." Edhe po nuk ia zgjidhëm hallin, nuk bën dot gjë. Ai s'ka asgjë në dorë, nuk na bën ndonjë dëm... Ata mendojnë se kanë arritur qiellin dhe për sa kohë që janë në atë pozicion, gjërat do të jenë ashtu siç i duan ata. Por nuk duhet të jetë kështu.

"Periudhë qetësie"

Personat e intervistuar theksuan se politikat dhe programet shtetërore ndihmojnë në përjetësimin e përjashtimit social: ato nuk bazohen tek parapëlqimet e komunitetit dhe i penalizojnë romët dhe egjiptianët për varfërinë e tyre.

Përparësi të imponuara. Një nga shqetësimet e ngritura nga aktivistët e komunitetit është se ndërhyrjet mbështeten në përparësi të imponuara, dhe jo në parapëlqimet e komunitetit rom dhe egjiptian. Një aktivist tha:

Ekziston një mospërputhje ndërmjet asaj se çfarë u nevojitet komuniteteve dhe çfarë bëjnë zyrtarët. Një komunitet mund të ketë nevojë për rregullimin e rrjetit të ujërave të zeza; kurse zyrtarët ndërtojnë një qendër komunitare. Romët dhe egjiptianët shihen si target, dhe jo si partnerë. Shumë shpesh, ajo që ndodh është se zëri i tyre nuk dëgjohet.

Ndëshkim dhe jo përkrahje. Ndërhyrjet e qeverisë perceptoheshin më së shumti si një instrument në duart e zyrtarëve për të ndëshkuar, dhe jo për të ndihmuar romët dhe egjiptianët. Një nga të intervistuarit tha: "Qeveria më thotë se fëmija im nuk duhet të lypë. Puna është se fëmija im lyp nga halli, jo nga qejfi. Po të kisha pasur një punë, nuk do ta nxirrja fëmijën në rrugë." Një aktivist i komunitetit tha se ndërhyrjet me anë të politikave shpesh ndiqen nga një *periudhë qetësie*:

Të marrim shembullin e nismës së [ish] ministrit për fëmijët e rrugës. Në rregull, t'i heqim fëmijët nga rruga e t'i kthejmë pranë familjeve të tyre. Po çfarë të bëjë familja pastaj? Çfarë të hanë? Plani nuk është menduar mirë. Prindërit duhet të gjejnë një punë; fëmijët duhet të shkojnë në kopsht, në shkollë, dhe të shoqërizohen me fëmijë të tjerë. Ata i hoqën fëmijët nga rruga dhe kjo u ndoq nga një periudhë qetësie. Ata do të kthehen përsëri, se nuk kanë asnjë mjet jetese.

Ndërrhyrje afat-shkurtra. Shpesh, ndërrhyrjet në komunitet janë afatshkurtra. Ndërrhyrje të tilla përshkruheshin si jo të frytshme. Një nga punonjësit e komunitetit tha se “megjithëse ne i ndihmonim familjet, u jepnim strehim dhe çdo gjë, kjo nuk sillte ndonjë ndryshim.” Një punonjës tjetër komuniteti na tha diçka të ngjashme: “Ti i mbështet, dhe duket se po ecin mirë, por sapo ua ndryshon ndihmën, për shembull, nuk i ndihmon me qiranë, ata kthehen aty ku ishin ... ti i mbështet për pesë ose gjashtë muaj dhe pastaj familja kthehet po aty ku ishte më parë.”

Shifra boshe. Numri i fëmijëve që ndjekin shkollën është shtuar, por kjo nuk do të thotë që arritjet e tyre akademike janë përmirësuar. Një prind më tha: “Vajza ime është në klasën e tretë, por nuk di të lexojë. Nuk e di se pse nuk e kanë ngelur në klasë.” “Si është e mundur që ajo është në klasë të tretë dhe nuk di të lexojë?” e pyeta. Ajo m'u përgjigj duke thënë: “Fola me mësuesen dhe i thashë që vajza ime nuk duhet ta kalojë klasën. Ajo më tha që na kanë thënë t'i kalojmë të gjithë, kështu që edhe ajo do të kalojë.” Në qoftë se mësuesit nuk i kalojnë të gjithë, atëherë do të marrin vlerësim të dobët. Nuk ka ndonjë marrëdhënie ndërmjet numrit të nxënësve që kalojnë dhe përgatitjes së tyre. Kjo tregon se standardet e përdorura për të vlerësuar punën e mësuesve duhet të rishikohen. Theksi duhet t'i vihet cilësisë së arsimimit.

Ndërrhyrje një-dimensionale. Politikat dhe programet shtetërore nuk marrin parasysh kompleksitetin e problemeve me të cilat përballen familjet romë dhe egjiptiane. Një nga anëtarët e komunitetit egjiptian e vlerësonte theksin që i vihej formimit profesional. Djali i tij ndiqte një kurs formimi profesional. Megjithatë, ai nuk gjente dot punë. Sipas tij, nuk mund të promovohet punësimi përfshirës nëse nuk luftohet diskriminimi. Ai tha: “Ata [të rinjtë] e ndjekin kursin, marrin diplomë, po nuk shkojnë dot gjëkund me të.”

Ndryshimi i sjelljeve. Punonjësit e komunitetit e quanin se e kishin për detyrë të ndryshonin sjelljet e romëve dhe egjiptianëve, si për shembull duke u mësuar disiplinën dhe menaxhimin e parave. Kur po përshkruante punën e saj, drejtorja e një prej qendrave kombëtare tha: “Ne fokusohemi tek fuqizimi i familjeve.” Pastaj ajo e përkufizoi fuqizimin si “t'i bindësh ata [romët dhe egjiptianët], që të ndjekin rregullat.” Në terren, punonjësit e komunitetit i vendosnin romët dhe egjiptianët para përgjegjësisë. Ata merreshin në pyetje. “Pse nuk e more në telefon zyrën e punës?” “E ke pastruar dhomën tënde?” “I ke larë enët?” “Pse e le punën?” “Pse nuk zgjohesh herët në mëngjes?” “Unë punoj shumë, edhe ti duhet të punosh shumë.” Këto qëndrime i penalizojnë romët dhe egjiptianët për varfërinë e tyre dhe e thellojnë tëhuajzimin e tyre nga shoqëria.

Sorollatje burokratike

Kohëzgjatja dhe kostoja e procedurave zyrtare bëjnë që romët dhe egjiptianët t'u qëndrojnë larg institucioneve shtetërore. Një nga të intervistuarit pyeti: “Si të shkoj në Pogradec [për të marrë një certifikatë]? Ne mezi mbushim barkun me bukë. Na shkon gjithë dita duke mbledhur plehra. Ne po vuajmë.” Një i intervistuar tjetër tha: “E kam çuar djalin në spital kushedi sa herë. Ata kërkonin kaq shumë dokumente, saqë hoqa dorë.”

Punonjësit dhe aktivistët e komunitetit ishin të mbytur me procedura zyrtare dhe përpiqeshin t'i zgjidhnin problemet përmes lidhjeve personale. Për shembull, ata kishin arritur t'u mbushnin mendjen drejtorëve të shkollave të regjistrin fëmijë romë në shkollat e tyre edhe kur nuk i kishin plotësuar të gjitha dokumentet. Drejtorët e shkollave vendosën t'i regjistrin këta nxënës nga dëshira e mirë, jo se ishin të detyruar në bazë të ligjit.

Një nga mënyrat me anë të të cilave aktorët institucionalë ndihmojnë në përjetësimin e përjashtimit të romëve dhe egjiptianëve është duke vazhduar t'i shpërfillin ata. Një anëtare e komunitetit egjiptian dhe aktiviste e komunitetit, na tregoi për përvojën e saj:

Morëm një letër [nga një zyrtar i qeverisjes vendore] që thoshte se ne duhet të shkonim në një vend tjetër; përndryshe, do të mbyteshim të gjithë në lumë. Ku? i pyeta. Më thanë se nuk e dinin. Dinin vetëm që duhet të iknim që andej... Ne shkuam tek Avokati i Popullit. Ai na tha se duhet të shkonim tek bashkia, sepse çdo gjë varej nga bashkia. Shkuam tek bashkia, dhe na thanë se nuk e kemi në dorë ne.

Të tjerë na treguan për raste diskriminimi. Gëzimi tha:

Diskriminimi është kudo, sidomos nëpër institucione. Nëse pret në radhë, ata [zyrtarët] thonë: prit, e ka radhën dikush tjetër. Të ngrihen kaq shumë nervat sa që do të zihesh me ta... Ne po prisnim në radhë [tek zyra e ndihmës ekonomike], kur ajo na tha: “Mbylleni gojën ju, jevgj të çmendur, mbani qetësi” ... E keqja është tek institucionet.

Në përgjithësi, sistemi i mbrojtjes sociale përshkruhej si jo efikas. Në veçanti, ofruesit e shërbimeve dhe punonjësit e komunitetit përmendnin se sistemit të mbrojtjes sociale i mungon kapaciteti reagues, transparenca, dhe llogaridhënia. Një nga veprimtarët e komunitetit tha:

Ofruesit e shërbimeve duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin: të raportojnë dhe të trajtojnë rastet. Ofruesit e shërbimeve duhet të jenë të detyruar të raportojnë dhe t'i referojnë rastet; kjo nuk duhet të lihet në dëshirën e tyre. Kjo mund të luftojë diskriminimin dhe të parandalojë problemet e rënda. Në praktikë, sistemi nuk funksionon ... Mekanizmat e llogaridhënies mungojnë: kush do të garantojë që fëmija të ketë libra? Që fëmija i ka bërë vaksinat? Kush do të merret me procedurat zyrtare? Në qoftë se fëmija jeton në një barakë dhe s'ka status banimi, çfarë do të bësh? Si ta regjistrosësh në shkollë? Çfarë do të ndodhë nëse nuk regjistrohet në shkollë?

Gjatë fushatave zgjedhore, kandidatët premtajnë se do t'ua ndryshojnë faqen lagjeve të varfra. Romët dhe egjiptianët e varfër i njihnin mirë premtime të tilla:

Vetëm gjatë zgjedhjeve kujtohen për ne. Bëjnë premtime: do të bëj këtë, do të bëj atë. Vetëm premtime bëjnë, asgjë tjetër. Çfarë lloj premtimesh bëjnë?

Premtojnë se do të gjejnë punë – mbi bazën e arsimit dhe profesionit; se do të mbështesin arsimimin e fëmijëve të tu. Të gjithë e dinë se këto janë premtime fushate zgjedhjesh ... Lagjia ime nuk ka rrugë të mira, s'ka drita. Të gjithë mbledhin shishe plastike; fëmijët ruajnë kazanët e plehrave. Duan të hanë. S'ka rëndësi se ç'bën. Uria nuk pret!

Ka pasur disa raste kur anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptianë janë bërë pjesë e institucioneve shtetërore. Duke qenë më afër pushtetit, ata mund të kenë mundësi më të mëdha për të ndikuar në marrjen e vendimeve. Po si e shohin ata ndikimin e tyre tek institucionet? Të zhgënjyer, ata thanë se zakonisht vetëm merren me mbajtje shënimesh ose me logjistikë. Ata nuk japin ndonjë ndihmesë të konsiderueshme. Kur e ngrenë zërin, për shembull, për të kundërshtuar konceptet e gabuara dhe stereotipat që kanë zyrtarët qeveritarë, ata ose shpërfillen ose kritikohen.

Përfundime dhe rekomandime

Ky studim përqendrohet në profilin e përjashtimit social të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Mbi bazën e 34 intervistave të zhvilluara me anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, aktivistë të komunitetit, ofrues të shërbimeve dhe zyrtarë qeveritarë, ky studim tregon se romët dhe egjiptianët janë mbërthyer në kurthe të shumëfishta që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe sjellin përjetësim të varfërisë së trashëguar në breza. Shpesh, ofruesit e të shërbimeve dhe profesionistët nuk kanë një kuptim të thelluar të varfërisë së trashëguar në breza dhe diskriminimit, dhe përdorin konceptet e gabuara ekzistuese për të shpjeguar sjelljet kundër-produktive. Ndërveprimet sociale e thellojnë tëhuajzimin dhe mungesën e besimit të romëve dhe egjiptianëve dhe ndihmojnë përjetësimin e përjashtimit social.

Është e rëndësishme të rrëzohen konceptet e gabuara që ekzistojnë për romët dhe egjiptianët. Kjo mund të arrihet në mënyra të ndryshme, për shembull duke i njohur njerëzit – përmes mediave, teksteve shkollore (të rishikuara), dhe debateve publike – me realitetet e familjeve romë dhe egjiptiane. Informacioni nuk duhet të fokusohet vetëm tek varfëria e tyre, por edhe tek ëndrrat, shpresat dhe shpirti i tyre i qëndrues. Përveç kësaj, vëmendja duhet të kalojë nga qasja që fajëson viktimën tek një qasje që merr parasysh pasojat psikologjike dhe në sjellje që shkakton varfëria dhe diskriminimi. Ky ndryshim rrënjësor do të mundësojë shqyrtimin e kompleksitetit të sjelljeve kundër-produktive dhe të mënyrave se si ato përjetësojnë varfërinë ndër breza dhe përjashtimin shoqëror në vite.

Theksi i shtuar mbi romët dhe egjiptianët ka bërë që ata të jenë më të dukshëm. Por çka ka ndodhur në të njëjtën kohë është se shpjegim për marginalizimin e tyre nga shoqëria kërkohet tek etniciteti, dhe jo tek varfëria ndër breza dhe diskriminimi. Veçanërisht sjelljet kundër-produktive shpesh i atribuohen tipareve kulturore të komunitetit. Gjetja e shpjegimit tek etniciteti, dhe jo tek varfëria brez pas brezi dhe diskriminimi, ka përforcuar idenë se romët dhe egjiptianët ndryshojnë shumë nga pjesa tjetër e popullatës.

Diskriminimi i romëve dhe egjiptianëve ka rrënjë të thella në institucione. Një nga mënyrat se si aktorët institucionalë e përjetësojnë përjashtimin social është përmes zbatimit të politikave që i ndëshkojnë romët dhe egjiptianët, në vend që t'i përkrahin ata. Politika të tilla mbështeten në premisën që sjellja e romëve dhe egjiptianëve duhet të "ndreqet." Politikat ndëshkuese e thellojnë tëhuajzimin dhe mungesën e besimit të romëve dhe egjiptianëve dhe sjellin përjetësimin e përjashtimit social. Një mënyrë tjetër përmes së cilës aktorët institucionalë kontribuojnë në përjetësimin e përjashtimit social është duke i shfuqizuar romët dhe egjiptianët në institucionet shtetërore. Këto përpjekje i përçajnë romët dhe egjiptianët, si dhe përpjekjet e tyre për të vepruar së bashku dhe për të sjellë ndryshim.

Analiza tregon se nevojitet një qasje shumë-përmasore për të trajtuar natyrën e ndërlikuar të problemeve që karakterizojnë romët dhe egjiptianët. Të marrim shembullin e arsimit. Sigurimi i teksteve shkollore nuk është i mjaftueshëm. Po aq të rëndësishme janë edhe programet mbështetëse, si programet e konsultimit pas shkollës, të transportit dhe ushqyerjes. Ofruesit e shërbimeve dhe aktivistët e komunitetit argumentuan se ekziston nevoja për një program të shumanshëm për të trajtuar problemet e ndërlikuara; megjithatë, ata ngritën edhe shqetësimin se sistemi i mbrojtjes sociale nuk është aspak efektiv dhe i mungojnë mekanizmat e llogaridhënies; mungon vullneti politik; dhe politikëbërësit i perceptojnë

ndërhyrjet shumëplanëshe si tepër të kushtueshme dhe pa ndonjë vlerë për elektoratin e tyre.

Dalja nga këto kurthe kërkon që romët dhe egjiptianët e varfër të bëjnë investime afatgjata. Banerjee & Duflo (2011) argumentojnë se të varfrit mund të bëjnë investime afatgjata në praninë e dy parakushteve. Së pari, ata duhet të kenë pritshmëri pozitive për të ardhmen. Në qoftë se e kanë humbur shpresën, pritshmëritë nuk janë të larta. Në fakt, të varfrit mund edhe t'u kthehen sjelljeve jo produktive sepse, siç e shpjeguan shumë nga personat e intervistuar, "s'na ka mbetur gjë tjetër." Së dyti, duhet të ekzistojë një ndjenjë qëndrueshmërie. Nëse njerëzit jetojnë të kërcënuar nga rreziku i përhershëm i dëbimit, ose nga rreziqe të tjera, ata do të heqin dorë së përpjekuri. Mbështetja e romëve dhe egjiptianëve ka të bëjë me sigurimin e këtyre dy parakushteve.

Shqyrtimi i kurtheve të shumta, të cilat i mbajnë romët dhe egjiptianët të mbërthyer në varfëri dhe përjashtim, tregon se theksi i ndërhyrjeve në nivelin e familjes duhet të vihet mbi promovimin e shëndetit fizik dhe mendor, sidomos duke ofruar mbështetje në rastet e të papriturave shëndetësore, si dhe për të trajtuar çështje si mungesa e shpresës, pesimizmi dhe stresi. Ndërhyrjet në komunitet duhet ta përqendrojnë vëmendjen tek informimi i romëve dhe egjiptianëve për mundësitë që ekzistojnë, si për shembull bursat shkollore. Anëtarët e komunitetit kërkuar programe për zhvillimin e aftësive për jetën, aftësive shëndetësore, aftësive të përkujdesit për trupin, aftësive për gatim, dhe aftësive komunikuese. Punonjësit, aktivistët dhe drejtuesit e komunitetit na dhanë shembuj të shumtë: zgjerimi i shërbimeve sociale dhe psikologjike në shkollë; ofrimi i strehimit të sigurtë; mbështetja e talenteve të reja – p.sh. në sporte, muzikë, tregti; ofrimi i shërbimeve të lëvizshme shëndetësore dhe të shëndetit riprodhues, dhe shërbimi dentar.

Ky studim tregon gjithashtu se, për sa kohë që procedurat zyrtare do të jenë të stërzgjatura dhe të kushtueshme, dhe zyrtarët do të përdorin praktika përjashtuese dhe diskriminuese, romët dhe egjiptianët do të mbeten të tëhuajzuar nga institucionet shtetërore. Mani dhe bashkëautorët (2013) ofrojnë sugjerime të shumta për përmirësimin e shërbimeve, për shembull, krijimin e formularëve të thjeshtë të aplikimit, dhënien e ndihmës për plotësimin e tyre, si dhe dërgimin e kujtesave (p.sh. për të ndjekur kurse, etj.). Në qoftë se shërbimet janë shumë kërkuese dhe i ngarkojnë të varfrit me një barrë të rëndë, ata do të heqin dorë. Gjatë ofrimit të shërbimeve, është e rëndësishme që romët dhe egjiptianët të inkurajohen dhe t'u jepet shpresë. Rëndësia e inkurajimit dhe shpresës doli në pah edhe në një intervistë me një nënë egjiptiane:

Ti [doktori] dëgjoji mendimet e saj, respektoje atë. E sheh që një gjë nuk është mirë, mbaj qetësinë dhe foli me të butë. Nënata rome kanë vuajtur shumë. Ato janë të mbytura nga ankthet dhe ndonjëherë nuk dinë. Mund të bëjnë gabime. Ato duhet të respektohen. Atyre duhet t'u mësohet, për shembull, kjo nuk bëhet kështu, po ashtu. Mos u shqetëso. Ne jemi këtu për të të ndihmuar. Gjërat do të shkojnë mirë. Në qoftë se një nënë i dëgjon këto, ajo do të lehtësohet.

Dalja e romëve dhe egjiptianëve nga varfëria dhe promovimi i përfshirjes sociale të tyre nuk ka të bëjë me "ndreqjen" e sjelljeve të tyre, por me heqjen e barrierave të ngulitura institucionale dhe ofrimin e mbështetjes që u mundëson atyre ta marrin vetë nën kontroll jetën e tyre.

REFERENCA

- Banerjee, A. V., & Duflo, E. (2011). *Poor economics: A radical rethinking of the way to fight global poverty* (Ekonomia e varfërisë: një ri-konceptim rrënjësor i mënyrës së luftimit të varfërisë globale). New York, NY: PublicAffairs.
- Bernard, R. H. (2011). *Research methods in anthropology* (5th ed.). (Metodat kërkimore në antropologji. Botim i pestë). Plymouth, UK: Altamira Press.
- GSDRC. (pa datë). *Social exclusion* (Përjashtimi social). Marrë më 1 shtator 2015 nga <http://www.gsdr.org/go/topic-guides/social-exclusion/social-exclusion-as-a-process>
- Houshofer, J. (2014). *The price of poverty: Psychology and the cycle of need*. (Çmimi i varfërisë: Psikologjia dhe qarku i nevojës). Marrë më 20 shtator 2015 nga <https://www.foreignaffairs.com/articles/africa/2014-07-15/price-poverty>.
- Lerner, J. S., Li, Y., & Weber, E. U. (2013). *The financial costs of sadness*. *Psychological Science*, 24(1) (Kostoja financiare e trishtimit. Shkenca psikologjike), f. 72-79.
- Mani, A., Mullainathan, S., Shafir, E., & Zhao, J. (2013). *Poverty impedes cognitive function*. *Science* (Varfëria pengon funksionin njohës. Shkenca), 341(6149), f. 976-980.
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. (2015). *Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2015 – 2020)*. Tiranë, Shqipëri: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
- Mullainathan, S., & Shafir, E. (2013). *Scarcity: Why having too little means so much*. (Mungesat: Pse të kesh shumë pak ka domethënie kaq të madhe) New York, NY: Times Books, Henry Holt and Company.
- Ryan, G. W., & Bernard, H. R. (2003). *Techniques to identify themes*. *Field Methods* (Teknikat për identifikimin e temave. Metoda të punës në terren) 15(1), pp. 85-109.
- Small, M. (2010). *Defining policy through evidence not preconceptions* (Përkufizimi i politikave përmes provave në vend të paragjytimeve). Marrë më 1 tetor 2015 nga <http://www.aapss.org/news/2010/06/18/mario-small-defining-policy-through-evidence-not-preconceptions>.
- Vohs, K. D. (2013). *The poor's poor mental power*. *Science* (Fuqia e varfër mendore e të varfërve). Shkenca, 341, f. 969-970.

